



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.352/2019**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Refiçe Tërnavës Beka, kandidate për deputete nga koalicioni Nisma-AKR-PD, paraqitur kundër komisionarëve të Qendrave të Votimit 1903E, QV 1905E, dhe QV 0901X, për shkak të mungesës së votave gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**HUDHET** e palejuar ankesa A.nr 352/2019 e datës 07.10.2019, e paraqitur nga Refiçe Tërnavës Beka, kandidate për deputete nga koalicioni Nisma-AKR-PD, me të cilën ka kërkuar që të Urhërohet KQZ që të bëjë rinumërimin e votave në: Shkolla Faik Konica Prishtinë, Qendra Votimit 1903E, Vendvotimi nr.1903E/08R, Fakulteti Filologjik, Prishtinë, Qendra e Votimit 1905E, Vendvotimit nr.1905E/01R, Shkolla Mihajl Gramena, Qendra e Votimit 0901X, Vendvotimi nr.0901X/09R, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës te datës 06.10.2019.

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 07.10.2019, ka pranuar një ankesë Anr.352/2019 nga Refiçe Tërnavës Beka, kandidate për deputete nga koalicioni Nisma-AKR-PD, në të cilën theksohet se gjatë procesit të numërimit të votave në Qendrat e Votimit dhe Vendvotimet si: Shkolla Faik Konica Prishtinë, Qendra Votimit 1903E Vendvotimi nr.1903E/08R, Fakulteti Filologjik, Prishtinë Qendra e Votimit 1905E Vendvotimit nr.1905E/01R, Shkolla Mihajl Gramena, Qendra e Votimit 0901X, Vendvotimi nr.0901X/09R, ku thekson se votuesit me mbiemër Tërnavës, Beka, Gashi, Humolli, të cilët janë familjar dhe njëkohësisht mbështetës të mi kanë votuar për mua, ndërsa këto vota nuk janë evidentuar në formularin për kandidat, përkatësisht si vota të numëruara për mua.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e palejuar**

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive në ditën e votimit, ku si rezultat i këtyre parregullsive ankuesja është dëmtuar në vota. Paneli duke marrë për bazë faktin për shkak se përmes kësaj ankese atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor-faza e procesit zgjedhor kur parashtrohet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hudhet poshtë e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, mund të ushtroj ankesën në afatin prej 24 orëve.

Bazuar në arsyet e sipërhënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe Nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “Ankesat të cilat janë të palejuar dhe të pasafatshme PZAP-i i hudhë poshtë me vendim”, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për hudhjen e ankesës të palejueshme nuk e prejjudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë/apelojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**A nr. 352/2019 më datën 10.10.2019**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*